



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA GJIROKASTËR  
KËSHILLI I BASHKISË  
KRYETARI I KËSHILLIT

Nr 654 Prot

Gjirokastër më 10 : 07 2023

**Lënda:** Procesverbal i mbledhjes së datës 16.06.2023

Në zbatim të Ligjit Nr. 139/ 2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Rregullores së Këshillit Bashkiak po ju vendosim në dispozicion procesverbalin e mbledhjes së datës 16.06. 2023

**PROCESVERBAL**

I mbajtur sot në **datë 16.06.2023** në mbledhjen e konstituimit të Këshillit Bashkiak Gjirokastër. Mbledhja po zhvillohet në sallën e universitetit “Eqrem Çabej”. Mbledhja fillon në orën 11:35. Marrin pjesë në mbledhje 31 anëtarë të mandatar nga Komisioni Qëndror I Zgjedhjeve. dhe

Hapet mbledhja nga znj. Etleva Yzo, Sekretar I Këshillit Bashkiak. Në zbatim të rregullores deklarohet hapja e mbledhjes dhe lexohet lista me 31 anëtarë të mandatar nga KQZ-ja.

Ftohet këshilltari më I vjetër për të drejtuar mbledhjen deri në zgjedhjen e kryetarit të Këshillit Bashkiak.

Z. Petrit Brahimi paraqet rendin e ditës I cili është I shpërndarë te të gjithë këshilltarët.

1. P/Vendim “Për ngritjen e Komisionit të Mandateve”.
2. P/ Vendim “Për miratimin e mandateve të Këshilltarëve”.
3. Betimi i anëtarëve të Këshillit Bashkiak.
4. P/ Vendim “Për zgjedhjen e Kryetarit të Këshillit Bashkiak”.
5. P/Vendim “Për zgjedhjen e nënkryetarëve të Këshillit Bashkiak”.
6. P/ Vendim “Për shpalljen e vlefshmërisë së mandatit të Kryetarit të Bashkisë dhe betimi i Kryetarit të Bashkisë”.

7. Fjala përshëndetëse e Kryetarit të Bashkisë.

8. P/ Vendim “Për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Bashkiak që do të përfaqësojnë Këshillin Bashkiak në Këshillin e Qarkut”.

Z. Brahimi: Në zbatim të rregullores së këshillit bashkiak fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës. P/Vendim “Për ngritjen e Komisionit të Mandateve”.

Në emër të grupit të Partisë Socialiste e merr fjalën zoti. Logo.

Përshëndetje të gjithë anëtarëve të Këshillit Bashkiak Gjirokastër për fitoren në zgjedhjet e 14 majit. Unë propozoj në emër të grupit të PS për Komisionin e Mandateve z. Armand Hilaj dhe z. Shkëlqim Guçe.

Z. Alko në emër të grupit Bashkë Fillojmë propozoj për anëtar të Komisionit znj.. Anila Cacaj.

Z. Gentian Logo propozon që votimi për anëtarët e Komisionit të Mandateve të bëhet I hapur meqë është konsesusi nga të dyja palët në këshillit.

Hidhet në votë propozimi për votim të hapur. Miratohet me 31 vota propozimi për votim të hapur. Miratohet me 28 vota pro ngritja e Komisionit të Verifikimit të Mandateve me përbërje si më poshtë vijon:

1. Armand Hilaj – kryetar
2. Anila Cacaj – sekretar
3. Shkëlqim Guçe – anëtar.

Komisioni I Verifikimit të Mandateve merr nga sekretari I këshillit dokumentacionin e ardhur nga KQZ-ja pas verifikimit i paraqet Këshillit Bashkiak raportin për vlefshmërinë e mandateve të këshilltarëve.

Lexohet raporti nga z. Armand Hilaj dhe deklarohet që nr I këshilltarëve të mandatuar nga KQZ-ja është 31 anëtarë.

Shpallet nga z. Brahimi : Konstituimi I Këshillit Bashkiak.

Hidhet në votë P/V “ Për miratimin e mandateve të këshilltarëve” dhe miratohet me 31 vota pro.

Pjesë e këtij vendimi është lista emërore e anëtarëve të Këshillit Bashkiak.

Z. Brahimi lexon formulën e betimit.

“Betohe në nderin tim se do të kryej me ndërgjegje detyrën e anëtarit të Këshillit Bashkiak dhe do t’i bindem Kushtetutës dhe ligjeve. Betohe se në të gjithë veprimtarinë time do të udhëhiqem nga interesat e shtetasve të Bashkisë Gjirokastër dhe do të punoj me ndershmëri dhe përkushtim për zhvillimin dhe rritjen e mirëqenies së tyre”.

Secili prej këshilltarëve sipas listës emërore deklaron “ betohem” dhe nënshkruan tekstin e betimit. Vendoset “ Himni i Flamurit” dhe shoqërohet sipas rregullit përkatës me qëndrimin në këmbë. Z. Brahimi: Deklaron kalimin në pikën 4 të rendit të ditës: P/ Vendim “Për zgjedhjen e Kryetarit të Këshillit Bashkiak”. Në emër të grupit të Partisë Socialiste e merr fjalën Z. Llogo: Propozimi ynë për Kryetar të Këshillit Bashkiak është për znj. Merita Isaraj. Propozimi administrohet nga sekretari I Këshillit Bashkiak. Në emër të grupi : Bashkë fitojmë, z. Aliko shprehet se nuk kanë kandidat për kryetar të Këshillit Bashkiak.

Z. Brahimi hedhe në votë propozimin për zgjedhjen e znj .Merita Isaraj Kryetare të Këshillit Bashkiak Gjirokastër. Miratohet me 30 vota pro propozimi për zgjedhjen e znj. Merita Isaraj si Kryetare të Këshillit Bashkiak Gjirokastër.

Z. Brahimi fton Kryetaren e Këshillit Bashkiak për të zënë vendin e saj .

Znj. Isaraj falënderon këshilltarët për besimin e dhënë dhe deklaron se do te punojë me përkushtim në shërbim të qytetarëve .

Vazhdon mbledhja me procedurën për zgjedhjen e nënkryetarëve të Këshillit Bashkiak.

Z. Gentian Llogo propozon znj. Manjola Shehaj për nënkryetare të Këshillit Bashkiak.

Hidhet në votë propozimi për znj. Shehaj dhe miratohet me 30 vota pro.

Znj. Manjola Shehaj zgjidhet nënkryetare e Këshillit Bashkiak Gjirokastër.

Z. Aliko propozon në emër të grupit z. Viron Peta për Nënkryetar të Këshillit Bashkiak.

Miratohet me 30 vota pro z. Viron Peta si Nënkryetar I Këshillit Bashkiak.

Znj. Isaraj vazhdon me pikën 6 të rendit të ditës. .

P/ Vendim “Për shpalljen e vlefshmërisë së mandatit të Kryetarit të Bashkisë dhe betimi i Kryetarit të Bashkisë”.

Lexohet Vendimi Nr. 211/21-2023-980, datë 07.06.2023 i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër për vërtetimin e mandatit të z. Flamur Golemi , I zgjedhur Kryetar I Bashkisë Gjirokastër në zgjedhjet vendore të 14majit 2023.

Znj. Isaraj hedh në votë P/ Vendim “Për shpalljen e vlefshmërisë së mandatit të Kryetarit të Bashkisë”.

Miratohet me 31 vota pro vlefshmëria e mandatit të Z. Flamur Golemi, Kryetar I bashkisë Gjirokastrë.

Lexohet nga znj. Isaraj formula e betimit. “Betohe me nderin tim se do të kryej me ndërgjegje detyrën e Kryetarit të Bashkisë Gjirokastrë dhe do ti bindem Kushtetutës dhe ligjeve. Betohe se në të gjithë veprimtarinë time do të udhëhiqem nga interesat e shtetasve të Bashkisë Gjirokastrë dhe do të punoj me ndershmëri dhe përkushtim për zhvillimin dhe rritjen e mirëqenies së tyre”.

Betohet z. Flamur Golemi, Kryetar I Bashkisë Gjirokastrë.

Z. Golemi mban fjalën përshëndetëse ku falënderon qytetarët e Gjirokastrës për besimin e dhënë të cilin e shikon si përgjegjësi për punë më të mira në zhvillimin e qytetit dhe falënderon dhe opozitën për vendin që ka zënë në Këshillin Bashkiak Gjirokastrë.

Kalohet te pika e fundit e rendit të ditës.

Z. Llogo propozon 4 anëtarë të Këshillit Bashkiak Gjirokastrë si përfaqësues në Këshillin e Qarkut.

1. Znj. Lindita Rova
2. Z. Sokol Feruni
3. Z. Gentian Llogo
4. Z. Armand Hilaj

Z. Aliko shprehet se nuk kanë asnjë propozim për në Këshillin e Qarkut.

Hidhen në votë dhe miratohen përkatësisht:

1. Znj. Lindita Rova me 29 vota pro, 1 kundër.
2. Z. Sokol Feruni me 28 vota pro, 1 kundër, 1 abstenim
3. Z. Gentian Llogo me 29 vota pro një kundër
4. Z. Armand Hilaj me 29 vota pro një kundër.

Mbyllet mbledhja e Konstituimit të Këshillit Bashkiak Gjirokastrë.

Sekretar  
Etleva Yzo

